Për: Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Nga: Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF
Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale
Rrjeti i Grave të Kosovës

Lënda: Kërkesë

Datë: 12 Nëntor 2026

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF (me 35 organizata anëtare), Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (me 108 organizata anëtare) ju drejtohemi me këtë kërkesë për të ngritur një çështje me rëndësi të veçantë për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, grave dhe familjeve në Kosovë: sigurimin e financimit të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për shërbimet sociale.

Në kuadër të diskutimeve dhe vendimmarrjes për Buxhetin e vitit 2027, konsiderojmë se është thelbësore që financimi i shërbimeve sociale të trajtohet si prioritet publik dhe të reflektohet në vendimet buxhetore të Kuvendit. Në këtë drejtim, dëshirojmë të ndajmë me ju disa nga sfidat kryesore të sistemit aktual dhe rekomandimet konkrete për adresimin e tyre.

Ndërsa Kosova po zhvillon reformën e mbrojtjes sociale, besojmë se duhet të adresohet një nga mangësitë më kritike strukturore të sistemit aktual: financimi i pamjaftueshëm dhe jo i qëndrueshëm i shërbimeve sociale. Pavarësisht progresit në zhvillimin e kornizës ligjore, niveli i financimit mbetet shumë prapa nevojave të fëmijëve dhe familjeve. Pa financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm, reforma nuk mund të zbatohet në mënyrë efektive.

Komunat kanë përgjegjësi për ofrimin e një game gjithnjë e më të gjerë të shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve, grave dhe familjeve, megjithatë shumë prej tyre nuk kanë kapacitetin financiar për të siguruar ofrimin e shërbimeve. Kjo kufizon parandalimin, ndërhyrjen në situata krize dhe mbrojtjen nga dhuna e abuzimi, duke vështirësuar ofrimin e shërbimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet përkatëse.

Vrasja tragjike e Arlinda Zekajt, pas raportimeve dhe kërkesave të përsëritura për mbrojtje, nënvizon nevojën urgjente për një reagim institucional efektiv ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Mbrojtja efektive kërkon vlerësim në kohë të rrezikut, masa konkrete për garantimin e sigurisë së viktimave, koordinim ndërinstitucional dhe qasje të vazhdueshme në shërbime të specializuara, përfshirë strehimin e sigurt, mbështetjen psikosociale dhe ndihmën juridike. Po ashtu, vrasja e foshnjës tre muajshe në Gjilan nënvizon urgjencën për forcimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve. Identifikimi i hershëm i rrezikut, ndërhyrja në kohë dhe menaxhimi i koordinuar i rasteve duhet të mbështeten nga një numër i mjaftueshëm profesionistësh dhe shërbime që udhëhiqen nga parimi i interesit më të mirë të fëmijës.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Coalition of NGOs for Child Protection
Koalicija NVO-ja za Zaštitu Dece

Rr: Sejdi Kryeziu
HY.1 K.4 No. 14
10000 Prishtina, Kosova

info@komfkosova.com
www.komfkosova.com
038 220 287

Financimi i mbrojtjes sociale mbetet kryesisht i përqendruar në transfere monetare, ndërsa shërbimet sociale, si ndërhyrje profesionale që parandalojnë përshkallëzimin e krizave dhe adresojnë cenueshmërinë e familjeve, vazhdojnë të marrin një pjesë dukshëm më të vogël të buxhetit. Në vitin 2024, Kosova shpenzoi rreth 854.6 milionë euro për mbrojtjen sociale, ndërsa shërbimet sociale përbënin vetëm rreth 1.6% të shpenzimeve të sektorit. Ky disproporcion tregon nevojën për një qasje më të balancuar, që krahas mbështetjes përmes transfereve monetare, investon më shumë në parandalim dhe shërbime profesionale për fëmijët dhe familjet.

38 Qendra për Punë Sociale dhe rreth 50 organizata joqeveritare të licencuara janë në vijën e parë të ofrimit të shërbimeve sociale. Megjithatë, ato përballen me kufizime të mëdha në burime njerëzore dhe financim. Qendrat për Punë Sociale vazhdojnë të jenë të mbingarkuara me reagim në raste emergjente, ku aktualisht, një zyrtar i QPS-së në komunat e mëdha ka rreth 350 lëndë aktive në vit. Organi i Kujdestarisë në shumicën e komunave nuk është i kompletuar me pesë profesionistët sipas kërkesës ligjore dhe nuk është funksional. Përveç mungesës së burimeve njerëzore, QPS-të përballen edhe me mungesë të theksuar të kushteve logjistike dhe infrastrukturore për ushtrimin efektiv të mandatit të tyre. Në shumë komuna, mungesa e automjeteve zyrtare dhe e mjeteve të nevojshme të punës e vështirëson realizimin e vizitave në familje, vlerësimin e drejtpërdrejtë të rasteve, ndërhyrjen në situata emergjente, përcjelljen dhe mbrojtjen e fëmijëve, si dhe ofrimin e shërbimeve në kohë.

Në anën tjetër, organizatat e licencuara që ofrojnë shërbime sociale për fëmijët, gratë dhe familjet në situata të cenueshme, përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët dhe gratë viktima të abuzimit dhe dhunës, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët e përfshirë në punë të rënda, personat përdorues të drogave, si dhe kategori të tjera të qytetarëve në nevojë për mbrojtje, përballen vazhdimisht me rrezikun e ndërprerjes apo mbylljes së shërbimeve për shkak të mungesës së financimit të qëndrueshëm. Kjo situatë rrezikon të cenojë vazhdimësinë e shërbimeve thelbësore dhe jetike, duke ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien, sigurinë dhe mbrojtjen e tyre.

Në këtë kuadër, kërkojmë që Buxheti i vitit 2027 të sigurojë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për shërbimet e specializuara për fëmijët dhe gratë që përjetojnë dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore. Ky financim duhet të mbulojë strehimin e sigurt, këshillimin psikologjik, ndihmën juridike dhe përfaqësimin, si dhe mbështetjen afatgjatë për rehabilitim, riintegrim dhe pavarësi ekonomike. Ndarjet buxhetore duhet të mbështesin vazhdimësinë e punës së organizatave të licencuara që ofrojnë shërbime rezidenciale, shërbimet në familje dhe shërbime ditore, si dhe bashkëpunimin e tyre me Qendrat për Punë Sociale dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Sipas analizave financiare, aktualisht nga buxheti i shtetit ndahen rreth 20 milionë euro në vit për shërbimet sociale. Për të përballuar kërkesat në rritje për shërbime, si dhe për të përmbushur kërkesat e legjislacionit dhe standardet minimale për ofrim të shërbimeve sociale, vlerësohet se nevojitet një financim shtesë prej 16 milionë eurosh në vit. Kjo do ta çonte financimin e përgjithshëm për shërbimet sociale në rreth 36 milionë euro në vit. Financimi shtesë prej 16 milionë eurosh përbën vetëm rreth 0.4% të projektbuxhetit të Kosovës për vitin 2027 (4.27 miliardë euro), ndërsa financimi i përgjithshëm prej 36 milionë eurosh do të përbënte më pak se 1% të tij. Ky investim do të përbënte një pjesë relativisht modeste të buxhetit të përgjithshëm, ndërsa do të mundësonte fuqizimin e parandalimit dhe ndërhyrjes së hershme, si dhe reduktimin e kostove shumë më të larta sociale dhe ekonomike që lidhen me dhunën ndaj fëmijëve, ndarjen e familjeve, kujdesin institucional, traumën e pa trajtuar dhe përjashtimin social.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Coalition of NGOs for Child Protection
Koalicija NVO-ja za Zaštitu Dece

Rr: Sejdi Kryeziu
HY.1 K.4 No. 14
10000 Prishtina, Kosova

info@komfkosova.com
www.komfkosova.com
038 220 287

Prandaj, propozojmë që deputetët:

- Të alokojnë buxhet të mjaftueshëm për Qendrat për Punë Sociale, në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve si pjesë e Grantit të Përgjithshëm të Qeverisë, për punësimin e 200 zyrtarëve të shërbimeve sociale (me fokus psikologët klinikë) në kuadër të Qendrave për Punë Sociale, me qëllim të plotësimit të kërkesave minimale ligjore për funksionalizimin e Organeve të Kujdestarisë, si dhe sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve logjistike, me qëllim të mundësimit të ofrimit të shërbimeve cilësore e në kohë për qytetarët. Kostoja shtesë e punësimit e 200 zyrtarëve të shërbimeve sociale në çdo komunë do të ishte rreth 1.68 milionë euro në vit.
- Të alokojnë buxhet të mjaftueshëm për Qendrat për Punë Sociale, në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve si pjesë e Grantit të Përgjithshëm të Qeverisë, për punësimin e më shumë zyrtarëve të shërbimeve sociale të cilët do të kenë përgjegjësi specifike për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Kostoja shtesë e punësimit të dy zyrtarëve në çdo komunë, për rastet e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën seksuale dhe dhunën në familje, do të ishte rreth 707,078 euro në vit për Qeverinë e Kosovës. Kjo shumë merr parasysh që Prishtina, si komuna më e madhe, do të kishte nevojë për katër zyrtarë të shërbimeve sociale. Rekomandojmë që kjo kërkesë të përfshihet nga të gjitha komunat në buxhetet e tyre, për zbatimin e kuadrit ligjor dhe të Protokollit të ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.
- Të rrisin buxhetin e dedikuar për thirrjen publike për organizatat e licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së tyre. Linja aktuale buxhetore prej 2,500,000 eurosh ka mbetur e pandryshuar dhe mbulon të gjitha shërbimet sociale dhe familjare, duke përfshirë strehimoret, shërbimet në familje dhe shërbimet ditore. Sipas raportit “Me çfarë kostoje?" publikuar nga RrGK, vetëm për mbulimin e shpenzimeve bazike të strehimoreve për viktimat e dhunës në familje nevojiten 2,339,631 euro. Ndërkaq, bazuar në të dhënat e organizatave anëtare të KOMF, shërbimet në familje dhe ato ditore aktualisht financohen mesatarisht vetëm në masën 25% të kostove të tyre. Prandaj, bazuar në nevojat e evidentuara dhe analizat financiare, propozojmë rritjen e buxhetit aktual për thirrjen publike për organizatat e licencuara, nga 2,500,000 euro në së paku 5,000,000 euro në vit.

Kërkojmë që, gjatë shqyrtimit të Buxhetit të vitit 2027, t’i trajtoni me prioritet këto rekomandime dhe të siguroni ndarjet buxhetore për zbatimin e tyre. Financimi duhet t’u mundësojë institucioneve dhe organizatave ofruese të përmbushin përgjegjësitë e tyre dhe të ofrojnë shërbime cilësore, të qasshme dhe në kohë, duke vendosur në qendër të drejtat, sigurinë dhe nevojat individuale të personave që marrin shërbime.

Me respekt,

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF (me 35 organizata anëtare)

Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale

Rrjeti i Grave të Kosovës (me 108 organizata anëtare)

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Coalition of NGOs for Child Protection
Koalicija NVO-ja za Zaštitu Dece

Rr: Sejdi Kryeziu
HY.1 K.4 No. 14
10000 Prishtina, Kosova

info@komfkosova.com
www.komfkosova.com
038 220 287